



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT

Nr. 68 prot. .

Fier, me 23/01/2025

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- 1.1 Përzierja e gazit duhet të jetë përzierje e hidrokarbureve të gazeve propan dhe butan në varësi të temperaturave ,me erën karakteristike të tij ,gjatë djegies krijon një flakë ngjyrë qielli në blu, në përputhje me Standardin Shqiptar SH EN 589:2018 +A1:2022 “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial”,sipas shtojcës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik , civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (Detar,Lumor dhe Liqenor)”,si më poshtë:

**TREGUESIT E CILËSISË PËR GAZIN E LËNGËZUAR QË PËRDORET
PËR QËLLIME REZIDENCIALE**

Përbërësit dhe treguesit e cilësisë	Njësia	GLN për përdorim termik dhe civil	
		min	max
Numri i oktanit motorik, NOM		-	-
Përmbajtja totale e dieneve (përfshirë 1,3 butadien)	% mol	-	0.5
Përmbajtja e sulfurit të hidrogjenit		negativ	negativ
Përmbajtja e përgjithshme e squfurit (pas erës së keqe)	mg/kg	-	50
Mbetje pas avullimit	mg/kg		60
Tensioni i avujve, manomatrik, në 40 °C	kPa		1000
Tensioni i avujve, manometrik, min temperature prej :	kPa	150	
Për klasën A	°C		-10
Për klasën B			-5
Për klasën C			0
Për klasën D			10
Për klasën E			20

Përmbajtja e ujit			Kalon
Aroma e pakëndshme dhe e dallueshme		Në 20% të KUN-së	

Raporti në funksion të stinës i gazit të lëngshëm nuk duhet të ketë ndotës të squfrit dhe gazra shoqëruese të tij, dhe praktikisht, në verë përdoret mishel (propan+butan), në dimër përdoret (propan).

1.2 Bombolat të plotësojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara sipas rregullit teknik përkatës, përfshirë edhe pajisjen e tyre me **deklaratën e konformitetit**.

1.3 Në sipërfaqen e bombolës duhet të pasqyrohen

- Të dhëna për markën tregtare të shoqërisë,
- Peshën neto dhe bruto, të shprehur në kilogram
- Simbolin e flakes së ndezshme
- Vitin e prodhimit
- Datën e kontrollit teknik
- Udhëzimin për përdorim të sigurt të tyre.

1.4 Bombulat duhet të kenë të stampuar në trup një numër serie me jo më pak se 6 shifra, në mënyrë që të jenë të identifikueshme nga njera-tjetra.

1.5 Bombolat me të cilat do të transportohet GLN duhet të plotësojnë standardet e kërkuara nga **Inspektoriati Shtetëror teknik dhe Industrial**.

1.6 Ambalazhimi i gazit do të bëhet me bombula gazi me kapacitet 15 kg, dhe duhet të jenë të testuara për sigurinë e tyre. Ato duhet të shoqërohen me dokumentacionin e testimit të tyre dhe me vulat ose marketimet përkatëse, të lëshuara nga institucionet përkatëse ,në përputhje me legjislacionin në fuqi për enët nën presion.

1.7 Bombulat sigurohen nga operatori ekonomik fitues.

1.8 Instalimi i bombulave të gazit nëpër kuzhina të institucionve tona të varësisë të bëhet nga punonjës te Kontraktorit ,të çertifikuar nga organe kompetente ne baze te Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

1.9 Rimbushja e bombulave dhe transportimi i tyre do të mbulohet nga operatori ekonomik fitues.

Grafiku i levrimit: Kontrata do të lidhet me afat kohor 12 muaj. Lëvrimi do të jetë periodik, sipas kërkesave të institucionve tona të varësisë (Kopshteve, Çerdheve,Konviktit dhe Shkollës Horizont), duke filluar nga lidhja e kontratës.

- Çdo furnizim me gaz të lëngshëm duhet të shoqërohet me fletë-analizën përkatëse të gazit, lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë,për origjinën dhe përbërjen e gazit të lëngshëm, që ata tregtojnë. Dokumenti të jetë origjinal, ose kopje e noterizuar.

ili do merret në dorezim me akt pritje. Komisioni përkatës, i pritjes së Gazit të Lëngshëm do të kryejë verifikimin e cilësisë në bazë të specifikimeve teknike si dhe sasinë e gazit të ardhur duke peshuar çdo bombul.

Për hartimin e specifikimeve teknike të Gazit të Lëngët për gatim dhe hartimin e kritereve teknike për kualifikim, i jemi referuar:

- Standardin Shqiptar SH EN 589:2018 +A1:2022 “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial”.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik , civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (Detar, Lumor dhe Liqenor)”.
- Ligjit Nr. 8450, date 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.
- Vendimit Nr. 212 datë 16.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombulave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”.
- Ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 1047 datë 16.07.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 170 date 25.04.2002 te Keshillit te Ministrave” , “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhenien e lejeve dhe të autorizimeve, për tregtimin e naftes, gazit e nënprodukteve të tyre”, te ndryshuar.
- Ligjin Nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar
- Ligjit Nr. 32/2016 “Për sigurinë e punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”.
- **Urdhri Nr. 128, date 08.04.2016** “Për miratimin e procedurave për kontrollin teknik të vlerësimit të konformitetit të bombulave të GLN”.

DREJTOR
SILVANA LAZE



Ekonomati
Mimoza PRIFTI

BASHKIA FIER
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT

Grafiku i furnizimit me gaz të lëngshëm për periudhën 12 Muaj ,viti 2025

Nr	Emertimi	Muaj I	Sasia për çdo muaj në kg											Shuma
			Muaj II	Muaj III	Muaj IV	Muaj V	Muaj VI	Muaj VII	Muaj VIII	Muaj IX	Muaj X	Muaj XI	Muaj XII	Totali
1	Gaz i lëngshëm për gatim	900	900	900	900	800	750	400	400	800	900	900	900	9,450

DREJTOR
SILVANA LAZE



EKONOMATI
MIMOZA PRIFTI